




ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHITETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr.35/2021

# Hapja e Kuvendit: Informimi dhe përfshirja e publikut në punën e deputetëve

Autore: Iva Naskova Aleksandra dhe Jovevska Gjorgjeviq

tetor 2021





*Ky Publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PMP), e mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PMP, zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (IND), Institutit për Demokraci „Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Kriza (QMK). Përmbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet e SDC.*



# Hyrje

---

Pandemia e shkaktuar nga virusi KOVID-19, ka vënë në test fuqinë e demokracive në nivel global dhe ka bërë të qartë se kur lidhjet midis disa degëve të qeverisjes janë të dobëta, demokracia si vlerë universale dhe si sistem i qeverisjes së mirë është gjithashtu e dobët. Dhoma ligjvënëse, luan një nga rolet më të rëndësishme në politikë, si institucion qendror i demokracisë përfaqësuese moderne, ndërsa një nga rolet e tij më të rëndësishme është të sigurojë përfshirje më të madhe të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Në këtë mënyrë rrit transparencën dhe përgjegjësinë ndaj publikut dhe praktikon funksionin e dhomës më të lartë përfaqësuese të qytetarëve.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas Kushtetutës, sovraniteti buron nga qytetarët dhe u përket qytetarëve, ndërsa hapja e Kuvendit dhe përfshirja e publikut në punën e tij është vendimtare për proceset demokratike të vendit. Kuvendi, si organ përfaqësues i qytetarëve dhe si bartës i pushtetit legjislativ, duhet të përpiqet t'i afrojë qytetarët dhe t'i informojë ata për punën e vet. Për të përmbushur këtë qëllim, Kuvendi ka mekanizma dhe mjete specifike për përfshirjen aktive të qytetarëve në faza të ndryshme të vendimmarrjes. Zbatimi i këtyre mekanizmave dhe mjeteve, të cilat

i shpjegojmë më poshtë, jo vetëm që do të rrisë informimin, transparencën dhe përgjegjshmërinë në punën e dhomës ligjvënëse, por do të rrisë besimin tek vetë institucioni, si dhe do të konfirmojë modelin e hapur dhe demokracinë përfaqësuese.

# I. Mekanizmat për përfshirjen dhe informimin e qytetarëve për punën e Kuvendit

Qytetarët kanë qasje në disa mekanizma dhe mjete përmes të cilave mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të garantuar për pjesëmarrje në punimet e Kuvendit dhe informimin e rregullt për punën e deputetëve.

## KOMUNIKIMI I DYANSHËM ME DEPUTETËT

Përveç punës së rregullt të deputetëve, pjesëmarrjes në trupat punues dhe seancat plenare në Kuvend, ata kanë për detyrë në pajtim me Rregulloren të vendosin kontakte të rregullta me qytetarët e njësisë së tyre zgjedhore. Për realizimin e këtyre kontakteve është rezervuar çdo ditë e fundit pune, e javës.

**Zyrat për kontakt me qytetarët** janë një nga mekanizmat që mund të lehtësojnë komunikimin e qytetarëve me deputetët. Këto zyra janë të vendosura në komnatat e deputetëve dhe atje janë angazhuar asistentë që menaxhojnë të gjithë procesin. Zyrat ofrojnë komunikim të drejtpërdrejtë, ku qytetarët kanë mundësinë të ndajnë propozime, sugjerime dhe mendime me të zgjedhurin e tyre<sup>1</sup>.

Faqja e Kuvendit shërben si mjet për komunikim të dyanshëm mes deputetëve dhe qytetarëve, ku përmes opsionit Pyete deputetin, qytetarët mund të komunikojnë në mënyrë elektronike me deputetin e tyre.<sup>2</sup>

## MONITORIMI I SEANCAVE NË KUVEND

Qytetarët mund të përfshihen në punën e Kuvendit përmes **pranisë fizike në seancat e Kuvendit**. Ajo që është e rëndësishme të përmendet është se seancat në Kuvend janë me karakter publik, përveç nëse vendoset ndryshe me shumicën e dy të tretave të deputetëve. Ajo që Rregullorja e Kuvendit parasheh si mundësi është që nëse qytetari shpreh interes për të marrë pjesë në seancë, duhet të plotësojë formularin që gjendet në ueb faqen e Kuvendit, përmes të cilit mund të aplikojnë për pjesëmarrje në seancë plenare. Të drejtë për vizitë kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Si mjete alternative për monitorimin e të gjitha seancave në Kuvend është **TV Kanali i Kuvendit** ku të gjitha seancat plenare dhe seancat e trupave punues transmetohen gjatë ditës. Seancat plenare drejtpërdrejt mund të ndiqen gjithashtu nëpërmjet **ueb faqes së Kuvendit**, ndërsa pas përfundimit të seancave janë të qasshme dhe në formë të incizimeve. Ato janë të qasshme vetëm përmes shfletuesit Internet Explorer.

## VIZITË NË NDËRTESËN E KUVENDIT

Një mundësi tjetër në dispozicion të qytetarëve është **vizitë në ndërtesën e Kuvendit në Ditën e hapur** që organizohet çdo të premte të fundit

<sup>1</sup> Zyrat për kontakt me qytetarët. Faqja e Kuvendit të RMV-së. <https://www.sobranie.mk/kancelarii-za-kontakt-so-graganite-map.nspix>

<sup>2</sup> Pyete deputetin. Faqja e Kuvendit të RMV-së. <https://www.sobranie.mk/prashaj-go-pratenikot.nspix>

të muajit. Ajo që duhet të bëjnë qytetarët e interesuar është të dërgojnë njoftim pesë ditë pune para vizitës në numrin e telefonit të Kuvendit, i cili gjendet në ueb faqen e Kuvendit. Duke pasur parasysh kufizimet e shkaktuara nga pandemia Covid-19, vizitat fizike në Kuvend plotësohen me **turne vizuale online**.

## UEB FAQJA E KUVENDIT

**Ueb faqja e Kuvendit** ofron një mori përmbajtjesh informative dhe edukative.<sup>3</sup> Qytetarët e interesuar këtu mund të informohen për aktivitetet e përditshme të deputetëve, trupave punuese dhe Kryetarit. Në ueb faqen gjithashtu mund të gjeni një pasqyrë të përbërjeve parlamentare aktuale dhe të kaluara, organizimin e shërbimit të Kuvendit, arkiv me video nga viti 2002 e deri më sot, si dhe një pasqyrë të fondit bibliotekar të Bibliotekës Parlamentare

**Kalendari i Kuvendit** i qasshëm në ueb faqe, ofron një pasqyrë të detajuar të orarit të aktiviteteve të deputetëve, rendin e ditës së seancave, si dhe qasje në të gjitha dokumentet përkatëse të seancës, procesverbalet e seancave, si dhe shënimet stenografike dhe videot nga seancat plenare. **Buxheti i Kuvendit**, në ueb faqen mund të gjenden edhe plani vjetor për prokurime publike, prokurimet publike dhe llogaritë përfundimtare, me çka sigurohet transparenca financiare e Kuvendit.

Të gjitha përmbajtjet në ueb faqen e Kuvendit janë të qasshme në maqedonisht, shqip, anglisht dhe frëngjisht. Informacionet e paraqitura në ueb faqen ndahet gjithashtu përmes **Profilet zyrtar të Kuvendit në rrjetet sociale Twitter, YouTube dhe Facebook**.

## KANALI TELEVIZIV I KUVENDIT

**Kanali televiziv i Kuvendit** si burim për marrjen e informacioneve për punën e Kuvendit ofron transmetim të drejtpërdrejtë të seancave plenare të Kuvendit, tregon pamjet e punës së komisioneve, debatet mbikëqyrëse dhe publike si dhe artikuj të tjerë informativ dhe edukativ.

## PËRFSHIRJA INTERAKTIVE E PUBLIKUT

**Instituti Parlamentar (IP)** organizon aktivitete për përfshirjen dhe informimin e publikut për punën e Kuvendit. Fokusi i veçantë i ndërveprimit janë të rinjtë, me të cilët zhvillohen shumë aktivitete edukative. Kështu, shkollat e mesme janë përfshirë në realizimin e aktivitetit **"Kam qëndrim"** qëllimi i të cilit është afrimi i procesit të miratimit të ligjeve me popullsinë e re. Në këtë mënyrë, IP kontribuon në zhvillimin e ndërgjegjësimit të tyre për demokracinë dhe i inkurajojnë dhe i përgatitin për kritikë dhe përfshirje sociale dhe politike. Përveç kësaj, si pjesë e këtyre aktiviteteve të IP-së, është simulimi i **"Parlamenti i Fëmijëve"**, përmes të cilit me qasje proaktive afrohet puna e Kuvendit tek të rinjtë. Aktivitete të tjera të IP-së, në këtë fushë janë **seminari edukativ njëditor për studentët** qëllimi i të cilit është njohja e pjesëmarrësve me rregullat sipas të cilave zhvillohen proceset parlamentare dhe puna e deputetëve në Kuvend dhe të tjera.

<sup>3</sup> Ueb faqja e Kuvendit. <https://www.sobranie.mk/pocetna.nsp>


## II. Perceptimi i qytetarëve për hapjen e Kuvendit

Instituti për Demokraci ka monitoruar vazhdimisht perceptimin e qytetarëve për punën e Kuvendit që nga viti 2008.<sup>4</sup> Ky aktivitet mundëson rishikim të vazhdueshëm të qëndrimeve të qytetarëve në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit, si dhe trendet lidhur me këto qëndrime në 13 vitet e fundit.

Rezultatet e nxjerra nga sondazhet në terren të kryera në periudhën 2018-2021, tregojnë se

qytetarët janë të ndarë në vazhdimësi sa i përket asaj se sa janë të njohur me punën e deputetëve në Kuvend. Kështu, në lidhje me punën e përbërjes aktuale parlamentare, 51% e qytetarëve u përgjigjën se janë pjesërisht ose plotësisht të vetëdijshëm me atë që deputetët kanë bërë nga gushti i vitit 2020 deri në janar 2021, ndërsa 48% u përgjigjën se ata pak ose aspak nuk janë të njohur me punën e deputetëve. Kjo situatë ka mbetur përgjithësisht e pandryshuar në katër vitet e fundit.

**Grafiku 1.** Deri në çfarë mase mendoni se jeni të njohur me atë që ka punuar Kuvendi në periudhën e kaluar nga gushti 2020 deri në janar 2021? (%)




<sup>4</sup> Perceptimi i qytetarëve për punën e Kuvendit. Analizë e rezultateve të siguruar nga anketat e kryera në periudhën 2009-2018. [shorturl.at/awBLS](http://shorturl.at/awBLS) ; Perceptimi i qytetarëve për punën e Kuvendit, 2019. [shorturl.at/estwN](http://shorturl.at/estwN) ; Perceptimi i qytetarëve për punën e Kuvendit, 2020. [shorturl.at/hkmwA](http://shorturl.at/hkmwA) ; Perceptimi i qytetarëve për punën e Kuvendit, 2021. [shorturl.at/hmvLT](http://shorturl.at/hmvLT) ;  
<sup>5</sup> Perceptimi i qytetarëve për punën e Kuvendit, 2021. [shorturl.at/hmvLT](http://shorturl.at/hmvLT)



Nga ana tjetër, kur është fjala për hapjen e Kuvendit për përfshirjen e publikut në punën e tij, më shumë se gjysma e të anketuarve në vitin 2021 (55%) besojnë se Kuvendi është plotësisht ose pjesërisht i mbyllur për publikun, që është 6 pikë të përqindjes më shumë krahasuar me vitin

2020. Në vitin 2019, përqindja e qytetarëve që besojnë se Kuvendi është plotësisht ose pjesërisht i mbyllur për punën e qytetarëve është 53%, ndërsa kjo përqindje e qytetarëve në katër vitet e fundit është më e larta në vitin 2018, kur ishte 61%.<sup>6</sup>


**Grafiku 2.** Deri në çfarë mase mendoni se Kuvendi është i hapur për pjesëmarrjen e publikut në punën e tij? (%)



Të pyetur për perceptimin e tyre për përfshirjen e vërejtjeve nga publiku dhe organizatat e shoqërisë civile në hartimin e ligjeve, pothuajse gjysma e të anketuarve në vitin 2021 (49%) thanë se deputetët

janë deri diku të mbyllur ndaj vërejtjeve publike. Duke marrë parasysh rezultatet e viteve të kaluara, mund të konstatohet se ky perceptim i qytetarëve është pothuajse i pandryshuar në tre vitet e fundit.<sup>7</sup>

**Grafiku 3.** Sa shpesh deputetët përfshijnë vërejtjet e publikut dhe organizatave të shoqërisë civile gjatë hartimit të ligjeve? (%)




<sup>6</sup> Ibid.

<sup>7</sup> Ibid.

Në pyetjen nëse qytetarët e dinë se kush është deputeti i njësisë së tyre zgjedhore, sipas anketës së fundit në terren të kryer në vitin 2021, emri i deputetit ishte i njohur për më shumë se dy të tretat e qytetarëve të anketuar (68%), që është

përqindja më e lartë në katër vitet e fundit. Në vitin 2020, 51% e të anketuarve, në vitin 2019, 54%, ndërsa në vitin 2018, 56% e qytetarëve deklaruan se e dinë kush është deputeti i njësisë së tyre zgjedhore.<sup>8</sup>


**Grafiku 4.** A e dini kush është deputet/ e nga njësia juaj zgjedhore? (%)



Në vitin 2021, 30% e qytetarëve deklaruan se deputeti i njësisë së tyre zgjedhore është në dispozicion për takime me qytetarët, ndërsa për pothuajse gjysmën e të anketuarve (45%) deputetët nuk janë të disponueshëm për takime me qytetarët. Megjithatë, ky perceptim është

pozitiv krahasuar me vitet e kaluara ku në vitin 2020 dhe 2019, deputetët ishin në dispozicion për takime vetëm për 21% të të anketuarve, ndërsa në vitin 2018, ky numër ishte më i lartë për katër pikë të përqindjes (25%).<sup>9</sup>

**Grafiku 5.** Deputeti/ja nga rajoni juaj (komuna, njësia zgjedhore) është në dispozicion për takime me qytetarë (%)




<sup>8</sup> Ibid.

<sup>9</sup> Ibid.

Sipas anketës së vitit 2021, një e katërta e qytetarëve (24%) thanë se deputetët e rajonit të tyre, aspak nuk i informojnë për punën e tyre. Mirëpo, krahasuar me vitin 2020, kur një gjë e tillë e kanë shprehur rreth 40% e të anketuarve, shihet se ky perceptim negativ është ulur për 16 pikë të përqindjes. Duke

pasur parasysh se në vitin 2019 dhe 2018 respektivisht 31% dhe 38% e qytetarëve kanë vlerësuar se deputetët nuk i kanë informuar për punën e tyre, mund të konstatohet se në vitin 2021, perceptimi për këtë çështje ishte më pozitiv në katër vitet e fundit.<sup>10</sup>


**Grafiku 6.** Deputetët nga rajoni juaj informojnë qytetarët për punën e tyre përmes (%)



Në vitin 2021, si mekanizmi më i përdorur që deputetët praktikojnë për raportimin për punën e tyre, qytetarët veçuan median dhe rrjetet sociale (19% secila). Nga ana tjetër, takimet në vende publike dhe evente publike (8%) si dhe në zyrat e deputetëve (8%) nga qytetarët i perceptojnë si më pak të praktikuara. Megjithatë, të pyetur si mendojnë se deputetët duhet të informojnë

publikun, të anketuarit si mjet të preferuar ende kanë veçuar takimet në vende publike (25%), ndërsa 19% e të anketuarve besojnë se deputetët duhet t'i informojnë ata përmes zyrave të deputetëve dhe ngjarjeve publike. 18% mendojnë se deputetët duhet ta bëjnë këtë përmes mediave.<sup>11</sup>

**Grafiku 7.** Në çfarë mënyre mendoni se deputetët nga rajoni juaj duhet t'i informojnë qytetarët për punën e tyre (%)




<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Ibid.

Perceptimi i përgjithshëm i qytetarëve është se deputetët nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme problemeve të komunës dhe komuniteteve lokale. Kështu, në vitin 2021, 43% e tyre besojnë se deputeti i rajonit të tij/saj nuk ka iniciuar ndonjë problem lokal, kundrejt 21% që kanë deklaruar se

një gjë të tillë e ka bërë deputeti i njësisë së tyre zgjedhore. Krahasuar me vitin 2020, përqindja e të anketuarve që mendojnë se deputetët nuk trajtojnë çështjet lokale është ulur me 10 pikë të përqindjes.<sup>12</sup>

**Grafiku 8.** A ka ndodhur që deputeti/ja nga rajoni juaj të ketë iniciuar një çështje në Kuvend për një problem me të cilin po përballlet komuna juaj? (%)



<sup>12</sup> Ibid.

### III. Hapi i Kuvendit në drejtim të hapjes ndaj qytetarëve

#### **PARTNERITET PËR QEVERISJE TË HAPUR (PQH) DHE KUVEND TË HAPUR**

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (PQH) është një nismë që ofron platformë ndërkombëtare për reformat e brendshme, që synon autoritete më të hapura, më llogaridhënese dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve. Ideja kryesore e PQH-së është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet zyrtarëve qeveritarë dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në krijimin e planeve të veprimit, përmes të cilave autoritetet dhe organizatat e shoqërisë civile mund të përipiqen për të arritur qëllimet. PQH është një mekanizëm rrjetëzimi ndërmjet institucioneve bartës të pushtetit, sektorit joqeveritar dhe qytetarëve në përgjithësi si ofrues të ekspertizës në fushën e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe përgjegjësisë. Gjithashtu, PQH monitoron ecurinë dhe përmbushjen e angazhimeve pasi ato miratohen dhe publikohen nga institucionet. Fillimisht, PQH ishte parashikuar të forconte pjesën e platformës që synonte pushtetin ekzekutiv, por në vitin 2014, PQH filloi të zgjerohej edhe kah pushteti legjislativ.

Parlamentet mund të arrijnë rezultate të jashtëzakonshme, nëse udhëhiqen nga parimet dhe vlerat e PQH-së dhe partnerëve kryesorë në avancimin e agjendës për qeverisje të hapur. Hapat e përhershëm dhe domethënës drejt qeverisjes së hapur kërkojnë mbështetjen dhe angazhimin e parlamenteve. Nëse PQH arrin një partneritet të suksesshëm me parlamentet, ky partneritet mund të mbështetet më tej për të zhvilluar dhe zbatuar reforma më ambicioze të qeverisjes së hapur. Qeverisja e hapur nuk mund të shihet si hapa të riparimeve teknike dhe procedurale, por si një aspiratë themelore politike për të përmirësuar

mënyrën e qeverisjes. Kështu, parlamentet, si një nga aktorët kryesorë në skenën politike, duhet të marrin pjesë në angazhimet për reformën për qeverisje të hapur.

Republika e Maqedonisë së Veriut u bë pjesë e platformës globale të PQH-së, në vitin 2011, ndërsa në përputhje me detyrimet që dalin nga kjo iniciativë, Qeveria miratoi Planin e parë të Veprimit për PQH në vitin 2012. Në vitin 2017, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut vendosi t'i bashkohet nismave të PQH-së, me aktivitet plotësues për arritjen e Kuvendit të Hapur. Kuvend i Hapur është gjithashtu një nga synimet e përcaktuara në Planin Strategjik të Kuvendit 2018-2020. Në përputhje me obligimet e ndërmarra, Maqedonia e Veriut deri më tani ka miratuar pesë plane nacionale të veprimit (në vitet 2012, 2014, 2016, 2018 dhe 2021) si dhe dy plane veprimi të Kuvendit (në vitin 2018 dhe 2021).

#### **PLANI I PARË I VEPRIMIT I KUVENDIT DREJT OBJEKTIVAVE TË PQH (2018 - 2020)**

Në korrik të viti 2018, u miratua Plani i parë i Veprimit i Kuvendit drejt qëllimeve të PQH-së. Ky Plan Veprimi mbulon 5 angazhime, të shpërndara në 3 parimet kryesore të PQH-së (tematika): Llogaridhënie, Qasje në informacione dhe Pjesëmarrja e qytetarëve. Për nevojën e përmbushjes së angazhimeve, Plani i Veprimit përcakton 12 arritje, ku secila arritje i kushtohet një angazhimi specifik.

Instituti për Demokraci, në kuadër të Programit për Mbështetjen Parlamentare, monitoron ecurinë e përmbushjes së angazhimeve dhe arritjeve në Planin e Veprimit. Pas skadimit të afatit kohor për

<sup>13</sup> Instituti për Demokraci "Societas Civilis" (2021) Plani i Veprimit i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt qëllimeve të Partneritetit për Pushtet të Hapur 2018 - 2020. Raport nga monitorimi, janar 2020 - janar 2021 Programi për mbështetje parlamentare

këtë Plan Veprimi, është konstatuar se nga gjithsej pesë, një angazhim ka përfunduar plotësisht, angazhimi **"Forcimi i shërbimit parlamentar në mënyrë që Kuvendi të përmbushë përgjegjësitë e zmadhuara me plotësimin e vendeve vakante dhe trajnimin e nëpunësve"**. Në kuadër të këtij angazhimi u realizuan plotësisht dy arritjet e planifikuara. **"Përgatitja e akteve të reja për organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me rishikimin funksional të kryer"** dhe **"Miratimi i një plani vjetor për trajnime gjenerike dhe të specializuara të nëpunësve shtetëror"**.

Një angazhim gjithashtu u përfundua në mënyrë të konsiderueshme, dhe ai është angazhim **"Rritja e transparencës financiare të Kuvendit"**. Arritja **"Publikimi i buxhetit të miratuar të institucionit dhe i bilancit të gjendjes në ueb faqen"** që ishte paraparë në kuadër të këtij angazhimi, u zbatua plotësisht. Nga ana tjetër, arritja e dytë **"Miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për buxhetet"**, është vlerësuar si i përfunduar në mënyrë të konsiderueshme deri në fund të kornizës kohore të Planit të Veprimit, pra në fund të vitit 2020.

Angazhimi me përfundim të kufizuar për **Infrastrukturë të përmirësuar të TIK-ut**, ku në kuadër të dy arritjeve të parashikuara, janë vërejtur hapa të caktuar nga pozicioni fillestar. Në këtë angazhim, ishin parashikuar **"Rritja e përqindjes së promovimit të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kuvendit në rrjetet sociale nga 30 në 60%", "Punim i ueb faqes së re të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut"**. Për shkak të kompleksitetit dhe vëllimit të

aktiviteteve të parapara në këtë angazhim, ai është paraparë edhe në Planin e ardhshëm të Veprimit të Kuvendit. Punimi i ueb faqes është në zhvillim, por afati kohor për finalizimin është zgjatuar për disa muaj, pjesërisht për shkak të nevojës për t'u lidhur me modulet e reja të sistemit e-parlament, i cili gjithashtu është në zhvillim e sipër.

Dy angazhime janë vlerësuar si të papërfunduara, **"Kanali televiziv i Kuvendit plotësisht funksional"** dhe **"Përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin legjislativ dhe mbikëqyrës të Kuvendit"**. Implementimi i arritjeve **"Studio televizive e pajisur"** dhe **"Skemë e përcaktuar programore"**, të cilat ishin parashikuar në **"Kanali televiziv i Kuvendit plotësisht funksional"**, kanë filluar në planin e parë të veprimit dhe janë transferuar edhe në të dytin, për shkak të kompleksitetit të specifikimeve teknike dhe prokurimit dhe procesi është duke u zhvilluar aktualisht në konsultim me furnitorët potencialë. Angazhimi i fundit, **"Përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin legjislativ dhe mbikëqyrës të Kuvendit"** parashikoi katër arritje: **"Rritja e përqindjes së trupave punues që përfshinin ekspertë në punën e tyre deri në 30%"**. - e papërfunduar; **"Aktet e miratuara që rregullojnë seancat mbikëqyrëse"** - i kufizuar i përfunduar; **"Plani për seancat mbikëqyrëse u miratua"** - e papërfunduar; dhe **"Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në seancat e trupave punuese deri në 70%"** - i kufizuar i përfunduar.

**Tabela 1.** Përmbledhje e nivelit të zbatimit të secilit angazhim nga Plani i Veprimit të PQH 2018-2020 deri në janar 2021<sup>14</sup>

ANGAZHIMET DHE ARRITJET	Data e fillimit:	Data e përfundimit:	Niveli i zbatimit
<b>1. Forcimi i shërbimit të Kuvendit në mënyrë që Kuvendi të përbushë përgjegjësitë e shtuara me plotësimin e vendeve vakante dhe trajnimin e nëpunësve.</b>	<b>01.2019</b>	<b>12.2021</b>	
D1.1. Përgatitja e akteve të reja për organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me rishikimin funksional të kryer	01.2019	12.2021	
D1.2. Miratimi i një plani vjetor për trajnimin gjenerik dhe të specializuar të nëpunësve shtetërorë	01.2019	12.2021	
<b>2. Rritja e transparencës financiare të Kuvendit</b>	<b>01.2019</b>	<b>12.2021</b>	
D2.1. Publikimi i buxhetit të miratuar të institucionit dhe i bilancit të gjendjes në ueb faqen e Kuvendit	01.2019	12.2021	
D2.2. Miratim i ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për buxhetet	01.2019	12.2019	
<b>3. Infrastruktura e përmirësuar e TIK-së</b>	<b>01.2019</b>	<b>12.2021</b>	
D3.1. Rritja e përqindjes së promovimit të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kuvendit në rrjetet sociale nga 30 në 60%	01.2019	12.2021	
D3.2. Zhvillimi i ueb faqes së re të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut	01.2019	12.2021	
<b>4. Kanali televiziv i Kuvendit plotësisht funksional</b>	<b>01.2019</b>	<b>12.2021</b>	
D4.1. Studio televizive e pajisur	01.2019	12.2019	
D4.2. Skema e përcaktuar programore	01.2019	12.2019	
<b>5. Përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin legjislativ dhe mbikëqyrës të Kuvendit</b>			
D5.1. Rritja e përqindjes së trupave punues që përfshinin ekspertë në punën e tyre deri në 30%	01.2019	12.2021	
D5.2. Miratim i akteve që rregullojnë seancat mbikëqyrëse	01.2019	12.2019	
D5.3. Plan i miratuar për seanca mbikëqyrëse	01.2019	12.2019	
D5.4. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në seancat e trupave punues deri në 70%	01.2019	12.2021	

\* legjenda e nivelit të zbatimit

■ E papërfunduar   ■ Përfundim i kufizuar   ■ Përfunduar në mënyrë të konsiderueshme   ■ Përfunduar

## PLANI I DYTË I VEPRIMIT I KUVENDIT DREJT SYNIMEVE TË PQH-SË (2021 - 2023)

Përgatitja e Planit të dytë të Veprimit të Kuvendit për periudhën 2021-2023, ka filluar në vitin 2020 dhe i gjithë procesi mund të vlerësohet si gjithëpërfshirës me konsultime të gjera me numër të madh të palëve të interesuara. Në periudhën mars 2020, si aktivitet i përbashkët i Kuvendit dhe Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), u realizua punësoria e parë me disa nga anëtarët e grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit dhe udhëheqës të sektorëve në Kuvend. Qëllimi i punësorisë ishte prezantimi i raporteve nga monitorimi i zbatimit të angazhimeve të Planit të Veprimit për Kuvendin e Hapur 2018-2020, diskutim mbi pikat e forta, fushat për përmirësim të të njëjtit plan, si dhe fillimi i përgatitjes së planit të ri të veprimit 2021-2023.

Më 25 gusht 2020, koordinatorët e GO-së të Kuvendit zhvilluan një takim konsultativ online me përfaqësuesit e grupit punues nga sektori civil. Në këtë takim u prezantua draft plani i parë zyrtar i veprimit, u shkëmbyen mendime për angazhimet dhe arritjet e identifikuar, si dhe u ofruan ide dhe komente shtesë nga sektori i shoqërisë civile. Më 28 tetor 2020, Kuvendi dhe PSP organizuan një konferencë virtuale për Kuvendin e Hapur, Plan Veprimi për POB 2021-2023. Kjo e-konferencë u organizua si pjesë e Javës së Hapjes së Legjislacionit #GLOW2020 të organizuar nga Rrjeti për Parlamentit të Hapur (OPeN) nga data 26 deri më 30 tetor 2020. Në konferencë u diskutua për rëndësinë e hapjes dhe transparencës së Kuvendit, Kuvendi në kontekstin e zhvillimeve të reja me pandeminë COVID-19, nevojën për përmirësimin e infrastrukturës së TIK-ut në Kuvend dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së pa penguar të qytetarëve në punën e Kuvendit.

Përmes diskutimit, nxënësit kontribuan me ide dhe komente në procesin e krijimit të planit të veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2021-2023.

Më 21 maj 2021, Kuvendi dhe PSP organizuan një ngjarje hibride për OVP me 22 organizata të shoqërisë civile, me qëllim finalizimin e bashkë-krijimit të Planit të dytë të Veprimit për 2021 - 2023. Në këtë mënyrë Kuvendi përfshiu shoqërinë civile në pjesën e konsultimeve publike, duke ofruar një mundësi më të madhe për të informuar dhe përfshirë sektorin civil në zhvillimin e mëtutjeshëm të Planit të Veprimit si dhe për të konfirmuar angazhimet e Kuvendit.

Në korrik 2021, Kuvendi miratoi Planin e Veprimit 2021 - 2023. Disa nga rekomandimet e propozuara nga shoqëria civile në të gjithë procesin e bashkë-krijimit u pranuan dhe u bënë pjesë e versionit përfundimtar të planit të veprimit, ndërsa disa u refuzuan. Plani i ri i Veprimit ka tre parime kryesore: **"Kuvendi për qytetarët me reagim të hapur dhe rikuperim të hapur nga pandemia Covid 19"; "Infrastruktura e përmirësuar e TIK-ut" dhe "Pjesëmarrja qytetare / Parlament i hapur"**. Qëllimet e Planit të Veprimit do të realizohen përmes realizimit të 11 arritjeve përkatëse. Në pjesën e parimit të parë këto janë arritjet: **"Zhvillimi i një portali online për të dhëna të hapura për qasje më të lehtë në informacione për qytetarët", "Platforma për propozime dhe iniciativa nga qytetarët deri te pushteti ligjvënës dhe regjistër të organizatave të shoqërisë civile", "Siguria digjitale përmes nënshkrimeve digjitale për deputetët dhe shërbimin e Kuvendit"**.

Në kuadër të pjesës së dytë të parimeve të PQH-së, parashikohen pesë arritje: **Zhvillimi**



i ueb faqes së re të Kuvendit për informim më të mirë të qytetarëve", "Kanal televiziv i Kuvendit plotësisht funksional", "Zhvillimi i një zgjidhje softuerike për monitorimin e procesit legjislativ nga publiku", "Softuerin për e -arkiv të hapur për kërkim nga publiku dhe e fundit" "Prokurimi i kamerave me pajisje përcjellëse për transmetimin e seancave në internet".

Parimi i tretë parashikon tre arritje: **Punim i reportazheve dhe prezantimi i publikut me promovim të zyrave për kontakt me qytetarët**", "Zbatimi i aktiviteteve për promovimin e partneritetit për qeveri të hapur" dhe "Prokurimi i një zgjidhje softuerike për të mundësuar përkthimin nga fjalimi në tekst".

## IV. Hapja e Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor


"Indeksi i Hapjes" është një tregues kompleks që mat shkallën në të cilën autoritetet në Ballkanin Perëndimor janë të hapura ndaj qytetarëve. Parlamentet janë një nga institucionet e përfshira me këtë indeks. Rezultatet, të cilat publikohen çdo vit në kuadër të këtij indeksi, tregojnë hapjen e pushtetit legjislativ në parlamentet e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Kosovës, Bosnje-Hercegovinës, Serbisë dhe Malit të Zi. Indeksi mat shkallën në të cilën parlamentet janë të hapura ndaj qytetarëve dhe shoqërisë, bazuar në katër parime: (1) transparencë (2) qasje (3) integritet dhe (4) efikasitet/ndërgjegjësim.<sup>15</sup>

Rezultatet e analizës së fundit të kryer për vitin 2018, tregojnë se është bërë një hap pozitiv në drejtim të hapjes së parlamenteve në Ballkanin Perëndimor. Mesatarja rajonale për hapjen parlamentare në vitin 2018 është 66%, që tregon një rritje prej 21 pikë të përqindjes krahasuar me vitin 2017 (45%). Megjithatë, dallime të rëndësishme rajonale mund të vërehen midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kështu, në vitin 2018, dhoma ligjvënëse e Malit të Zi vlerësohet si më e hapura me një indeks prej 79,23%, pasuar nga parlamentet e Kosovës dhe Shqipërisë me indeks 73.1% përkatësisht 72.11%. Në vendin e katërt është dhoma ligjvënëse e Maqedonisë së Veriut me 66,43%, në vendin e pestë - Serbia - 58,21%, ndërsa Parlamenti i Bosnjës dhe Hercegovinës është vlerësuar më dobët- 46% (grafiku 8).<sup>16</sup>

<sup>15</sup> Indeksi rajonal i hapjes. ActionSEE. <https://opennessindex.actionsee.org/type/parliament>

<sup>16</sup> Indeksi rajonal i hapjes 2018. ActionSEE <https://opennessindex.actionsee.org/type/parliament>  
Indeksi rajonal i hapjes 2017. ActionSEE <https://opennessindex2017.actionsee.org/type/parliament>

**Grafiku 8.** Niveli i hapjes së parlamenteve të Ballkanit Perëndimor, 2018




Ndryshime vërehen edhe në aspektin e vlerësimit të veçantë të katër parimeve mbi të cilat bazohet Indeksi i Hapjes. Kështu, në vitin 2018, sa i përket parimit të transparencës, parlamentet e Malit të Zi (79,09%) dhe të Kosovës (78,73%) janë vlerësuar më së miri. Parlamenti i Maqedonisë së Veriut është në vendin e tretë sipas transparencës (66,32%), pasuar nga parlamentet e Shqipërisë (60,45%), Serbisë (58,54%) dhe Bosnjës dhe Hercegovinës (49,74%). Shqipëria renditet e para për sa i përket qasjes në Kuvend për qytetarët (83,43%). Parlamenti i Malit të Zi është vlerësuar me 69,82%, ndërsa ai i Maqedonisë së Veriut me 63,02%. Pas tyre vijnë parlamentet e Serbisë (58,88%), Kosovës (55,62%) dhe Bosnjës dhe Hercegovinës (37,16%). Integriteti

më i lartë është i vlerësuar në Parlamentin e Malit të Zi me 92,86%, pasuar nga parlamentet e Kosovës dhe Shqipërisë në të njëjtin nivel me 82,86%. Integriteti i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut vlerësohet me 70,24%, me 56,67% i Serbisë dhe me 45,05 i Bosnjës dhe Hercegovinës. Për sa i përket efikasitetit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve, Kuvendi i Malit të Zi sërish është vlerësuar më lartë (84,48%). Pas tyre vijnë parlamentet e Kosovës (80,95%), Shqipërisë (78,52%) dhe Maqedonisë së Veriut (71,43%). Parlamentet e Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë janë të fundit në listë me 58,75% dhe 57,14% në mënyrë përkatëse (grafikët 9, 10, 11 dhe 12).<sup>17</sup>


Grafikët 9,10,11,12.

Niveli i hapjes së parlamenteve nga Ballkani Perëndimor sipas parimeve të ndryshme, 2018


**Niveli i hapjes në bazë të transparencës**




**Niveli i hapjes në bazë të qasjes**



**Niveli i hapjes në bazë të integritetit**



**Niveli i hapjes në bazë të ndërgjegjësimit**



<sup>17</sup> Indeksi rajonal i hapjes 2018. ActionSEE <https://opennessindex.actionsee.org/type/parliament>

# Përfundim

---

Kuvendi ka një nga rolet më të rëndësishme në jetën politike të një shteti demokratik. Që të mund të realizojë funksionet e tij, është e nevojshme të jetë efikas, transparent dhe i përgjegjshëm ndaj qytetarëve dhe të sigurohet përfshirja e tyre më e madhe në proceset vendimmarrëse.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut i informon qytetarët përmes mjeteve të tij zyrtare për informim të publikut, gjegjësisht përmes kanalit të Kuvendit dhe ueb faqes së Kuvendit. Mirëpo, ajo që vihet re është se qytetarët janë përgjithësisht të ndarë sa i përket njohjes së tyre me punën e Kuvendit, dhe kjo gjendje është relativisht e pandryshuar në vitet e fundit. Qytetarët përmendën kanalet televizive, internetin përmes portaleve informative dhe rrjeteve sociale si burimin e preferuar për informim në lidhje me punën e Kuvendit.

Për të promovuar transparencën dhe për të përfshirë publicitetin në punën e tij, Kuvendi me Planin e parë të Veprimit 2019-2021 iu bashkua nismës globale Partneritet për Qeverisje të Hapur (PQH). Zbatimi i angazhimeve dhe arritjeve të parashikuara në këtë plan veprimi në përgjithësi janë përmbushur pjesërisht. Gjithsesi duhen përmendur faktorë të jashtëm që e kanë vështirësuar përmbushjen e disa angazhimeve, si imobilizimi i shkaktuar nga pandemia e Korona dhe mosfunksionimi i Kuvendit deri në shpërndarjen e tij në shkurt dhe konsolidimi i parlamentit të ri në gusht 2020.

Analizat e Indeksit të Hapjes tregojnë përmirësim të transparencës së parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mesatarja rajonale e matur në vitin 2018 (66%), tregon një rritje prej 21 pikë të përqindjes krahasuar me vitin 2017 (45%). Megjithatë, duhet theksuar se ka dallime rajonale ndërmjet parlamenteve të ndryshme në vendet e këtij rajoni, ku Parlamenti i Malit të Zi në përgjithësi vlerësohet si më i hapuri në rajon.

## Rekomandime

Është veçanërisht e rëndësishme që Kuvendi të punojë në mënyrë proaktive për promovimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, si dhe për përfshirjen e tyre në proceset e punës së tij. Prandaj nevojitet komunikim më intensiv dhe më adaptues me qytetarët, si dhe përfshirja e tyre në punën e Kuvendit. Për të promovuar këtë hapje, në vazhdim janë disa rekomandime se si të arrihet kjo:

- Përfshirja e përpjekjeve më të guximshme dhe reformuese në planet e veprimit të POA. Duhet të synohet drejt përfshirjes së të gjitha funksioneve të Kuvendit me plane veprimi, të cilat do të siguronin publicitet dhe llogaridhënie në të gjitha fushat e punës së Kuvendit. Në këtë drejtim, duhet të parashikohen përpjekje që i referohen promovimit dhe praktikës më të shpeshtë të rolit mbikëqyrës të deputetëve, në mënyrë që të bëhet një hap i rëndësishëm përpara në hapjen e Kuvendit ndaj publikut.

- Investim më i madh në burime për zbatimin e planit të Veprimit OVP. Për realizimin e planeve të OVP-së, nevojitet angazhim dhe investim më i madh i përpjekjeve dhe burimeve serioze. Duke pasur parasysh se rrjeti OVP ofron mbështetje për implementim, si materiale ashtu edhe konsultative, Kuvendi mund ta parashikojë dhe ta përdorë atë gjatë planifikimit. Përveç kësaj, sektori i shoqërisë civile si partner në proceset e OVP-së mund t'i vërë në dispozicion burimet e veta në zbatimin e Planit të Veprimit.

- Intensifikimi i informimit dhe përfshirja e publikut në punën e Kuvendit. Është e nevojshme që në mënyrë aktive të promovohen mekanizmat që janë në dispozicion të qytetarëve për përfshirjen e tyre në punën e Kuvendit. Në këtë pjesë duhet bërë një hap përpara për të inkurajuar qytetarët që t'i përdorin këto mekanizma.

- Modernizimi i kanaleve zyrtare të Kuvendit për komunikim me publikun. Është e nevojshme që në vazhdimësi të bëhet përshtatja me trendet e reja të informimit që janë aktuale tek qytetarët përmes modernizimit të vazhdueshëm teknologjik dhe TI modernizimit të kanaleve ekzistuese të komunikimit, por edhe përdorimit të të reja.

- Përshtatja e burimeve të informimit sipas grupeve të ndryshme të synuara. Në vitin 2021 janë miratuar ndryshime pozitive për rregullimin programor të Kanalit të Kuvendit në Ligjin për Kuvendin si kornizë për përmirësimin e mëtejshëm të transmetimit parlamentar. Kuvendi duhet ta monitorojë vazhdimisht atë zhvillim, dhe të investojë në zhvillimin e mëtutjeshëm të Kanalit të Kuvendit dhe ueb faqes së Kuvendit si burime kryesore të informimit të Kuvendit, në mënyrë që më mirë t'i informojë qytetarët. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet informimit të të rinjve, në mënyrë që të rritet interesimi i tyre për punën e Kuvendit, si dhe të zhvillohen mekanizma të rinj për animimin e tyre. Edhe pse Kuvendi përmes Institutit Parlamentar ka hartuar një program për edukimin dhe përfshirjen e nxënësve të shkollave të mesme dhe universiteteve në punën e Kuvendit, këto përpjekje duhet të zgjerohen dhe intensifikohen. Kombinimi i aktiviteteve ekzistuese që realizohen në kuadër të Kuvendit, me pasurimin e përmbajtjeve edukative në këtë fushë në programin shkollor, janë mekanizëm i mirë që praktikohet në parlamentet e tjera.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHITETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr.35/2021

-

**Harja e Kuvendit:**  
**Informimi dhe përfshirja e publikut**  
**në punën e deputetëve**

Autore: Iva Naskova Aleksandra dhe Jovevska Gjorgjeviq

-

tetor 2021